

VENDIM
Nr. 576, datë 28.8.2019

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË (HUAMARRËSI) DHE KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE, SHA, (AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT), DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR PROGRAMIN “ENERGJI UJORE DHE SIGURIA E DIGAVE NË KASKADËN E DRINIT”, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 85/2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi) dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., (Agjencia zbatuese e projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin “Energji ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit”, ratifikuar me ligjin nr. 85/2015, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KfW

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë /Shqipëri
Faks: (+355) 4 222 8494

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. (KESH)
Blloku “Vasil Shanto”
Rruga: Eshref Frashëri, Kopleksi Vision nr. 8
Tiranë, Shqipëri

Zona e Biznesit
KfW Entwicklungsbank
Jakob Bihlmayer – Waldmann
Ref. jonë.: BG76
Tel: + 49 697431-6579
Faks.: + 49 69 7431-2944
jakob.bihlmayer-waldmann@kfw.de
Data: 27.3.2019

Bashkëpunimi Financiar me Republikën e Shqipërisë
Energji ujore dhe Siguria e Digave në Kaskadën e Drinit
Marrëveshja e Huasë e datës 30.6.2015; Huaja nr. 26946

I/e nderuar Zotëri ose Zonjë,

Referuar Marrëveshjes së lartpërmendur të Huasë, ne kemi kënaqësinë t'iu informojmë se ne jemi dakord të zgjasim afatin e disbursimit deri më 31 maj 2021. Gjithashtu, do të rregullohet emri dhe adresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Për të kontribuar në finalizimin e suksesshëm të këtij projekti, KfW në mënyrë të jashtëzakonshme do të mbulojë kostot shtesë të rifinancimit të shkaktuara nga zgjatja e periudhës së disbursimit. Ju lutem vëreni se në zgjatjet e ardhshme të periudhave të disbursimit, shpenzimet e rifinancimit mund t'i ngarkohen Huamarrësit.

Si rrjedhojë, ne pajtohemi me modifikimet e mëposhtme të Marrëveshjes së Huasë:

Seksioni A - Ndryshimet e Marrëveshjes së Huasë

Marrëveshja e Huasë dhe Programit do të ndryshohet, si më poshtë.

1. Emërtesa “Ministria e Financave” do të fshihet dhe do të zëvendësohet nga “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” kudo që përmendet në të gjithë tekstin e Marrëveshjes së Huasë dhe Programit.

2. Neni 3.2 Afati i fundit për kërkesën e disbursimit, do të fshihet dhe zëvendësohet si më poshtë:

“KfW-ja ka të drejtë të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 31 maj 2021.”

3. Neni 6.1 Tabela e Shlyerjes, do të fshihet dhe zëvendësohet me sa vijon:

“Huamarrësi do të paguajë Huanë si më poshtë:

Pagesat	Data		Vlera
1	30 qershor	2021	1,538,461.53 EURO
2	31 dhjetor	2021	1,538,461.53 EURO
3	30 qershor	2022	1,538,461.53 EURO
4	31 dhjetor	2022	1,538,461.53 EURO
5	30 qershor	2023	1,538,461.53 EURO
6	31 dhjetor	2023	1,538,461.53 EURO
7	30 qershor	2024	1,538,461.53 EURO
8	31 dhjetor	2024	1,538,461.53 EURO
9	30 qershor	2025	1,538,461.53 EURO
10	31 dhjetor	2025	1,538,461.53 EURO
11	30 qershor	2026	1,538,461.53 EURO
12	31 dhjetor	2026	1,538,461.53 EURO
13	30 qershor	2027	1,538,461.64 EURO

4. Në pikën 13.2 Adresa për njoftime për Huamarrësin, do të fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

“Për Huamarrësin: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bul. “Dëshmorët e Kombit”, nr.3

Tiranë/Shqipëri

Faks: (+355) 4 222 8494

Seksioni B - Dispozita shitesë

1. Kjo Letër nuk ndryshon ose nuk heq dorë nga ndonjë dispozitë tjetër e Huasë dhe Marrëveshjes së Projektit, përveç përcaktimit të qartë në këtë Letër.

2. Dispozitat e nenit 9 (Kostot dhe detyrimet publike), nenit 10.5 (Pajtueshmëria), nenit 13.2 (Adresat), nenit 14.3 (Pavlefshmëria e pjesshme dhe hapësirat), nenit 14.4 (Formulari me shkrim), nenit 14.6 (Ligji i zbatueshëm) dhe nenit 14.9 (Dispozitat ligjore) të Marrëveshjes së Huasë, të datës 30 qershor 2015, duhet të përfshihen në këtë Letër sikur të përcaktohen plotësisht në këtë Letër dhe sikur referencat ndaj këtyre klauzolave të Marrëveshjes janë referenca ndaj kësaj Letre.

Ju lutem konfirmoni miratimin tuaj për modifikimin e lartpërmendur, duke nënshkruar në një formë të detyrueshme ligjore dhe duke kthyer një origjinal te KfW-ja.

Përgatitur në tre origjinale në gjuhën angleze.

Me respekt:

KfW

Sarah Bongard

Pablo Obrador

Drejtues i Divizionit

Drejtuese e Projektit

KfW Development Banka KfW Banka e
Zhvillimit

KfW Development Banka (KfW Banka e
Zhvillimit)

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë, më 21.6.2019

Tiranë, më 19.6.2019

.....
Për dhe në emër të Republikës së
Shqipërisë
Emri: Anila Denaj
Titulli: Ministër i Financave dhe
Ekonomisë

.....
Për dhe në emër të Koorporatës
Elektroenergjitike Shqiptare
Emri: Benet Beci
Titulli: